

AKT NORMATIV Nr. 11, datë 27.3.2020

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Neni 1

Në nenin 36/1, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje: “Përjashtimisht parashikimeve të nenit 15, të këtij ligji, pagesat e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin kryhen pranë bankave të nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare, sh.a., për llogari të administratës tatimore, për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2020 brenda datës 20 tetor 2020, ndërsa për tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2020 brenda datës 20 dhjetor 2020.”

AKT NORMATIV Nr. 19, datë 23.4.2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të pikës 9, të nenit 27, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje: “Nga pagesa e kësaj takse përjashtohen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.”

Neni 2

Paragrafi i dytë, i nenit 36/1, ndryshohet, si më poshtë vijon: “Përjashtimisht parashikimeve të nenit 15, të këtij ligji, pagesat e kësteve të parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin në vitin 2020 nuk do të paguhen.”

VKB nr 25 , date 26.06.2020, “Për disa ndryshime në VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër” të ndryshuar”

1. Të përjashtohen nga tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim publik), për një periudhë 3 mujore të vitit 2020, për të gjitha bizneset me xhiro vjetore deri në 14 milion, ambulantët dhe OJF, në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative.

Subjektet përfituese të cilat kanë paguar detyrimet para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, vlera e falur për periudhën 3 mujore, do t’u njihet si tepriçë kreditore për vitin e ardhshëm.

2. Të përjashtohen nga tarifat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim publik), për një periudhë 6 mujore të vitit 2020, kategoritë si më poshtë vijon:

- Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes).
- Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)
- Kryefamiljarët gra me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç)

në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative.

3. Shtyerjen e afatit të pagesave të taksave dhe tarifave vendore deri me datë 30 tetor 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesve:

- Individë, familje;
- Persona fizik dhe juridik, ambulant;
- OJF, Institucione publike;

në territorin e Bashkisë Shkodër dhe Njësitë Administrative.